



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I BUXHETIT, FINANCËS DHE TAKSAVE-TARIFAVE

Datë 08.07.2026

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Projekt-vendimin (titulli i projektvendimit): PËR MIRATIMIN E NDIHMËS FINANCIARE ME VLERË TOTALE PREJ 10,242,173 (DHJETË MILIONË E DYQIND E DYZET E DY MIJË E NJËQIND E SHTATËDHJETË E TRE) LEKË, PËR LIKUJDIMIN E PLOTË TË FAMILJEVE TË DËMTUARA NGA PËRMBYTJET E SHKAKTUARA NGA RESHJET INTENSIVE TË SHIUT TË MUAJVE SHTATOR DHE NËNTOR 2025.

Baza ligjore:

Në zbatim të Ligjit nr.139 dt.17/12/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, Vendimit nr. 329 datë 16. 05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies të ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Vendimit Nr.414, datë 08.07.2021, “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, VKM-së nr. 290, datë 17.05.2023, “Për një ndryshim në Vendimin Nr. 414, datë 08.07.2021, “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, si dhe shkresës së Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile me Nr. 429/6 prot, datë 15.04.2026 “Për likuidimin e plotë të ndihmës financiare për familjet përfituese”

Propozimi nga kryetari/këshilltarët/tjetër (Çfarë propozohet në projektvendim):

Kryetari i bashkisë, sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtjes Civile, i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë konform akteve ligjore dhe të vendosë:

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare me vlerë totale prej 4,812,971 (katër milion e tetëqind e dymbëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e një) lekë, për 24 (njëzet e katër) familje të dëmtuara nga përrabytjet e shkaktuara nga reshjet intensive të muajit shtator 2025, të cilat do të likujdohen plotësisht, banorë të Njësive Administrative nr.2, nr.4, nr.5, nr.6, sipas aneksit nr.1.
2. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare me vlerë totale prej 5,429,202 (pesë milion e katërqind e njëzetë e nëntë mijë e dyqind e dy) lekë, për 26 (njëzet e gjashtë) familje të

dëmtuara nga përmbytjet e shkaktuara nga reshjet intensive të muajit Nëntor 2025 të cilët do të likujdohen plotësisht, banorë të Njësive Administrative Ishëm, Manëz, Sukth, nr.5, sipas aneksit nr.2.

3. Miratimin e përdorimit të fondit me vlerë totale prej 10,242,173 (dhjetë milionë e dyqind e dyzet e dy mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë, nga fondi i kushtëzuar për mbrojtjen civile, i akorduar me shkresën e Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile me nr. 429/6 prot, datë 15.04.2026 për likuidimin e plotë të ndihmës financiare për familjet përfituese, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi.
4. Ky fond do të merret Fondi i Kushtëzuar për Emergjencat Civile për vitin 2026, i alokuar me shkresën e Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile me shkresën nr. 429/6 prot, datë 15.04.2026, sipas destinacionit të përcaktuar: *"Shtetas të ndihmuar, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme"* – kod i produktit 91707AB.
5. Aneksat nr. 1 dhe 2 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Buxhetit, si dhe Drejtoria Ekonomike.

Analiza Financiare/ Buxheti total/natyra e financimit (të ardhurat e veta, transferata etj):

Fondi i Kushtëzuar për Emergjencat Civile për vitin 2026.

Drejtoria/Spektori përgjegjës që ka përgatitur materialin:

Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtjes Civile

Impakti social/grupet që preken:

Banorët e Bashkisë Durrës.

A është objekt konsultimi: (PO/JO)

JO.

Komisioni i përhershëm/përkohshëm i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave, u mbledhë më datë 08.07.2026, dhe shqyrtoi pikën nr. 12 të rendit të ditës, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij.

Komunikimi midis administratës dhe komisionit i përhershëm/përkohshëm:

Kryetari hapi mbledhjen për pikën 12 rendit të ditës. Bëri pyetje nëse ka. Të gjithë anëtarët pranë ishin dakord për ta kaluar për votim në Këshillin Bashkiak.

Për sa më sipër, pas shqyrtimit, të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojnë Këshillit Bashkiak:

- a- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim
- b- Miratimin e projekt aktit
- c- Refuzimin e miratimit të projektaktit
- d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
- e- _____

Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave

Kryetar

Rolant Xhelilaj

Pro Rely

Zv/Kryetar

Erzen Laçi

Sekretar

Hekuran Markola

PRO Hec

Anëtar

Jonada Mamo

PRO Mamo

Anëtar

Alfred Mullaraj

PRO An

Anëtar

Kastriot Xhongoli

pro Xhongoli

Anëtar

Silvana Agasi

Anëtar

Dritan Burgija

Anëtar

Jonuz Myshketa

Pro Myshketa

Anëtar

Xhojana Gjineci

Anëtar

Kontjana Kuçi